



Pranimi / Donesori Primitelj / Pritësi Received / Received by	26. 04. 2021	1	viti god year
Organ / Organizata Organ / Organisation Org / Orgt	to Part to Part Part No	Shtesa Petyq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2008/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.237/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2656/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 22.03.2021 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.499/2019 të datës 28.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: fshati Jashanicë, Komuna e Klinës, kundër organit të punësimit Komuna e Klinës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.04.2021, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.499/2019 e datës 28.08.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet ne fuqi Vendimi me numër 02.Nr.112-3134/2019 i datës 30.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës.

A r s y e t i m

Komuna e Klinës, pas marrjes së autorizimit nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil/MAP të datës 24.05.2019, ka shpallur konkursin me datë 27.05.2019 me nr. reference: JP000392241 për pozitën “Zyrtar i Regjistrimit të Pagave” në komunën e Klinës në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Më datën 25.06.2019 Komuna e Klinës ka bërë publike shpalljen për kandidatin e suksesshëm, në të cilin shpallje ankuesi nuk ka qenë kandidati i përzgjedhur.

I pakënaqur me njoftimin e datës 25.06.2019 për kandidatin e përzgjedhur, ankuesi më datë 24.07.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës më datë 30.07.2019 ka nxjerr Vendimin me numër 02.Nr.112-3134/2019 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 02.Nr.112-3134/2019 të datës 30.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Klinës, më datë 28.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3940/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.09.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës. Komuna e Klinës më datë 12.09.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 10.10.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 22.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2656/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.10.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 28.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 28.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 30.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës; Ankesën e ankuesit e datës 24.07.2019 e parashtruar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës; Konkursi-shpallja e rekrutimit e datës 27.05.2019; Shpalljen e rezultateve e datës 25.06.2019 për rezultatin dhe kandidatin e përzgjedhur; vendimi për pezullim i datës 28.06.2019; E-mailin e datës 11.07.2019; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 05.07.2019; Përgjigjen në kërkesë e datës 12.09.2019; Kërkesën për fillimin e rekrutimit e datës 16.05.2019; Shpalljen e rekrutimit e datës 27.05.2019; Konkursi i shpallur në gazetën “Bota sot” me datë 28.05.2019; Autorizimin e DASHC/MAP të datës 24.05.2019; Njoftimi për pezullim të procedurës e datës 27.06.2019; Deklaratë e datës 11.06.2019; vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 12.06.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar; Njoftimi i kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Formulari i përcaktimit të kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formulari MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj; Formulari i Renditjes përfundimtare të kandidatëve; Formulari Form. MAP-SHCK-08a për Vlerësimin individual i kandidatëve për endin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Raporti final i rekomandimit i datës 25.06.2019; Njoftimi për listën e ngushtë i datës 17.06.2019; rezultati i testeve me shkrim i datës 20.06.2019; Formulari i aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formularin e aplikimit i ankuesit me dosjen e bashkangjitur; Çertifikatë e datës 24.06.2015; Referencë e datës 21.06.2016; Referencë e datës 21.06.2016 e bërë nga Gjyqtari Çertifikatë e datës 06.01.2017; Çertifikatë e kursit të gjuhës angleze; Diploma e datës 12.11.2015 me nr.3661; kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Çertifikatë e lindjes e datës 05.06.2019; Formulari i aplikimit i kandidatës me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatës së përzgjedhur me dosjen e bashkangjitur; Vërtetimi i datës 30.05.2019; letërnjoftimi i ankueses; Çertifikatë e notave e datës 22.03.2017; Fletë Dëshmi i datës 23.11.2018; vërtetim i datës 08.06.2018; vërtetim i datës 30.11.2015; vërtetimi i datës 13.09.2018; vendimi i datës 04.04.2018; Letër

rekomandim nga Gjyqtare Letër rekomandim nga Prokurori Diploma e datës
 15.09.2013; Formulari i aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit
 i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatës me dosjen
 e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i
 aplikimit i kandidatit me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatit
 me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatës me dosjen e bashkangjitur;
 Formulari i aplikimit i kandidatës me dosjen e bashkangjitur; Formulari i aplikimit i kandidatit
 me dosjen e bashkangjitur; Testet me shkrim të datës 19.06.2019; Testi me shkrim i ankuesit
 i datës 19.06.2019; Testi me shkrim i kandidatës së përzgjedhur i datës 19.06.2019; Fletëdërgesa e datës
 31.07.2019; Fletë paraqitja e ankesës e datës 24.07.2019; Aktgjykimin e Gjykata Themelore në Prishtinë—
 Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2656/19 të datës 22.03.2021; Njoftimin e Këshillit
 të datës 10.10.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës
 të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili
 pretendon se Komuna e Klinës ia ka përshtatur kriteret e konkursit kandidatës së përzgjedhur si dhe procedura
 e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore, nenin 18 të Ligjit Nr.03/L-149 për
 Shërbimin Civil të republikës së Kosovës, si dhe përzgjedhja e kandidatës nuk është bërë në bazë të meritës
 dhe por mbi bazën e manipulimit të testit me shkrim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të dërguar nga Komuna e
 Klinës, ka konstatuar se sipas konkursit të datës 27.05.2019 të shpallur në gazetën “Bota Sot” si dhe në bazë
 të autorizimit të Departamenti të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP të datës 24.05.2019 kushtet kriteret
 e konkursit për pozitën “Zyrtar i Regjistrimit të Pagave” kanë qenë: *“Diplomë Universitare-Fakulteti Juridik
 dhe Ekonomik pa përvojë pune ose Shkollë e Lartë dhe 2 vite përvojë pune”*, andaj me këtë rast Kolegji ka
 konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën “Zyrtar i regjistrimit të pagave” kanë qenë në pajtim me Katalogu
 e Vendeve të Punës në Shërbimi Civil të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me vendimin nr.09 të datës
 21.02.2018 nga ministri i Ministrisë së Administratës Publike, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se
 kandidatës së përzgjedhur i janë përshtatur kriteret e konkursit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si
 dhe gjatë shqyrtimit të prova të lëndës, ka konstatuar se në listën e ngushtë më numër 02Nr.112-24491/2019
 të datës 17.06.2019 ka hyrë edhe kandidatja e përzgjedhur e cila në bazë të formularit të
 aplikimit të datës 05.06.2019 me dokumentacionin e bashkangjitur posedon Diplomë Universitare me
 numër:133 të datës 15.09.2015 me të cilën dëshmohet se ka mbaruar Fakultetin Juridik në Universitetin
 “Haxhi Zeka” dhe me këtë rast i ka plotësuar kriteret e konkursit, po ashtu edhe ankuesi në bazë të formularit
 të aplikimit të datës 05.06.2019 me dokumentacionin e bashkangjitur posedon Diplomë Universitare me
 numër:3661 të datës 12.11.2015 me të cilën dëshmohet se ankuesi ka mbaruar Fakultetin Juridik në
 Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe po ashtu i ka plotësuar kriteret e konkursit andaj mbi këtë
 bazë më rastin e përfshirjes në listën e ngushtë të ankuesit si dhe të kandidatës së përzgjedhur Komisioni
 Përzgjedhës i Shërbimit Civil, ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të
 Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili ka përcaktuar se: *“1.Anëtarët
 e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1. arsimimi dhe kualifikimi profesional”*.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se në
 testin me shkrim për pozitën “Zyrtar i regjistrimit të pagave” të mbajtur me datë 19.06.2019 ankuesi në bazë të
 Raportit Final të Rekomandimit të datës 25.06.2019 si dhe në bazë të Formularit Form. MAP-SHCK-08a me
 numër referencë:JPoo039241 ka arritur të grumbullojë 77 (shtatëdhjeteshtatë) pikë dhe është renditur i

katërti, ndërsa ankuesja ka arritur të grumbulloi 89 (tetëdhjetenëntë) pikë dhe është e renditur e para si dhe gjatë analizimit të testit me shkrim të ankuesit dhe të kandidatës së përzgjedhur nuk është vërejtur ndonjë parregullsi e cila mund ta ketë favorizuar respektivisht dëmtuar ndonjërin nga kandidatët në procedurë rekrutimi dhe me rastin e ftesës për intervistim me gojë komisioni përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil nenit 36 paragrafit 2, i cili përcakton: *“kandidatët të cilët kalojnë me sukses testin me shkrim ose arrijnë të mbledhin 50% të pikëve të përcaktuara nga KPSHC pranohen të hyjnë në testimin me gojë”*, ndërsa në bazë të Raportit Final me Rekomandim për pozitën zyrtar i regjistratit të pagave në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim me numër 01Nr.112-26336/2019 kandidatja e përzgjedhur na bazë të testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka qenë kandidatja me më së shumti pikë të grumbulluara gjithsejtë 87 (tetëdhjeteshtatë) dhe është renditur e para në listë, ndërsa ankuesi është renditur i katërti me gjithsejtë 73.5 (shtatëdhjetetripikëpesë) andaj me rastin e rekomandimit për përzgjedhje të kandidatës së përzgjedhur Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 40 paragrafi 1 i Rregullores 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i përcakton se: *“në Shërbimi Civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testin me shkrim dhe me gojë”* si dhe në pajtim me nenin dhe nenin 11 paragrafi 1 i Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: *“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Komunës së Klinës gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Regjistratit të Pagave” ka vepruar në pajtueshmëri me të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 18 paragrafi 1 i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimit e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”,* ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme si e tillë ankesa e ankuesit refuzohet si e pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Klinës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër me numër 02.Nr.112-3134/2019 të datës 30.07.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.237/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit,*
- *Kryetarit të Komunës së Klinës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunës së Klinës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

